



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN**

Nr. 2295 Prot.

Datë 28.02.2025

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.16, dt.28.02.2025

**MBI MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE
PËR NDJEKJEN PENALE EFEKTIVE TË KRIMEVE ZGJEDHORE**

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale” i ndryshuar, ligjin nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, ligjin nr.7895, dt.27.01.1995 “Kodi Penal i RSH” i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.02, datë 18.02.2025 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”, Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për marrjen e masave efektive kundër krimeve zgjedhore” mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.259 prot., dt.12.02.2025, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ligjin nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit” si dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, duke i'u referuar edhe Urdhërit nr.2100, dt.19.02.2025 të Drejtorit të DVP Elbasan,

Me qëllim :

- *Garantimin e të drejtës kushtetuese të qytetarëve për të votuar në një proces të lirë dhe të ndershëm zgjedhor, nëpërmjet sigurimit të integritetit dhe paanshmërisë së ndjekjes penale, në kuadër të hetimit të veprave penale gjatë procesit zgjedhor ;*
- *Unifikimin e masave për rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale ndaj krimeve zgjedhore ;*
- *Parandalimin dhe hetimin e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025, përmes kryerjes së hetimit të veprave penale në mënyrë të plotë, në kohë të arsyeshme dhe me transparencë, në funksion kjo edhe të parandalimit të kryerjes së këtyre veprave penale ;*
- *Konsolidimin e një politike penale efektive për hetimin me përparësi të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke synuar kryerjen e veprimeve të plota hetimore, administrimin e provave të nevojshme, trajtimin me efikasitet të informacioneve dhe indicjeve, në funksion të ndëshkimit penal në gjykim të autorëve të këtyre veprave penale ;*
- *Rritjen e koordinimit mes të gjitha agjensive ligzbatuese në ndjekjen penale të krimeve zgjedhore ;*
- *Forcimin e një qasje proaktive të hetimit dhe provueshmërisë në kohë reale e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve, duke synuar efekte konkrete për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe pacënueshmërinë e të drejtës së qytetarëve për të votuar në zgjedhjet për Kuvendin 2025 ;*

Përsa më sipër, udhëzoj :

Neni 1

Seksioni i Posaçëm i Përkohshëm

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, krijohet, organizohet dhe funksionon : **Seksioni i Posaçëm i Përkohshëm kundër Krimit Zgjedhor**, me drejtues seksioni Drejtuesin e Prokurorisë, me përbërje si vijon :

PËRBËRJA E SEKSIONIT			
Nr.	Prokuror	OPGJ Seksioni Prokurorisë	OPGJ Shërbimi Pol.Shtetit
1	Xhelian Seferi	Xhaferr Muha	Komisar Dorian Paganika
2	Glenda Zeneli	Altin Xhetani	Komisar Denis Sinani
3	Gëzim Spahiu	Drini Pasho	N/Komisar Edison Pemaj
4	Ledion Tema	Bledar Xhoxhaj	N/Komisar Orgest Muçmata
5	Gjergji Ceka	Ilir Haxhia	N/Komisar Skerdilajd Kusi
6	Ermira Manelli	Laureta Fusha	
7		Armanda Shahini	
8		Armino Visha	
9		Nevruz Ndrejoni	
10		Hasan Asllani	

Neni 2

Afati i Seksionit të Posaçëm

Seksioni i Posaçëm i Përkohshëm kundër Krimit Zgjedhor do të funksionojë deri më datë 31.05.2025. Çështjet penale të ndara për shkak të këtij seksioni do të ndiqen nga momenti fillestar i marrjes dijeni dhe deri në përfundimin e çështjes dhe/ose mbylljes së praktikës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal nga i njëjti prokuror të cilit i është ndarë çështja.

Neni 3

Shpërndarja e çështjeve

Shpërndarja e çështjeve që lidhen me krimet zgjedhore do të kryhet me short elektronik përmes sistemit CAMS dhe vetëm ndërmjet prokurorëve të këtij seksioni të posaçëm.

Neni 4

Shërbimi i gatishmërisë së përforcuar

Zv.Drejtuuesi i Prokurorisë, krahas shërbimit të gatishmërisë së zakonshme, përpilon grafikun e shërbimit të gatishmërisë së përforcuar për krimet zgjedhore. Grafiku përfshin periudhën para

dhe pas zgjedhjeve, që fillon me hapjen e fushatës zgjedhore 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve, vijon me ditën e zgjedhjeve dhe përfundon me shpalljen e rezultatit përfundimtar nga KQZ. Shërbimi i gatishmërisë së përforcuar organizohet në bazë të kompetencës territoriale të komisariteve/stacioneve të policisë. Ndarja e çështjeve të gatishmërisë kryhet sipas Udhëzimit të Përgjithshëm nr.3/2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.08/2024 “Për efektivitetin e shërbimit të gatishmërisë” të Prokurorit të Përgjithshëm. Grafiku i shërbimit të gatishmërisë së përforcuar i komunikohet Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 5

Delegimi i kompetencës ¹

Zëvendës drejtuesi i Prokurorisë Z.Xhelian Seferi, duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të mbulojë të gjitha problematikat që kanë të bëjnë me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve si dhe të gjitha veprat penale rrethanat e të cilave ose personat e përfshirë në to mund të lidhen me procesin zgjedhor të dt.11.05.2025, duke i’u deleguar të gjitha kompetencat që ka Drejtuesi i Prokurorisë për drejtimin e prokurorisë dhe në ushtrimin e ndjekjes penale të përcaktuara në nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", dhe që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenet 5-11 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.02, datë 18.02.2025 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me SPAK, Policinë e Shtetit dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese.

Neni 6

Veprimtaria e drejtuesit

Drejtuesi i Prokurorisë përmbush detyrimet e përcaktuara në nenet 12-15 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.02, datë 18.02.2025 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”, që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me KQZ, raportimin periodik dhe informimin e publikut dhe medias, bashkëpunimin me publikun, OJF-të, bashkëpunimin me Sektorin e Monitorimit dhe Sektorin e Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokurori Kreshnik Ajazi për shkak të funksioneve të tij si drejtues i prokurorisë si dhe të ngarkesës që buron nga ky udhëzim, përjashtohet nga shorti i ndarjes së çështjeve për krime zgjedhore dhe shërbimi i gatishmërisë së përforcuar.

Neni 7

Veprimtaria e policisë gjyqësore

Policia gjyqësore përmbush detyrimet e plota ligjore dhe kryen me diligjencë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të përcaktuara në K.Pr.Penale nën drejtimin, kontrollin dhe autoritetin e prokurorit të çështjes ose prokurorit të gatshëm, që nga momenti fillestar i marrjes njoftim mbi ngjarjen/kallëzimin dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Oficerët e policisë gjyqësore njoftojnë menjëherë dhe pa vonesë sapo marrin njoftim mbi një krim zgjedhor prokurorin e gatshëm sipas grafikut të gatishmërisë së përforcuar dhe më pas është prokurori i gatshëm ai që përcakton oficerin e policisë gjyqësore që do të kryejë veprimet hetimore si dhe jep orientimet e nevojshme.

Neni 8

Administrimi i të dhënave nga Zyra e Regjistrimit

Zyra e Regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan administron me kujdesin e duhur dhe të shtuar të dhënat në regjistra fizik dhe elektronik mbi materialet që i përkasin veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Informacioni nga regjistrat përpilohet vetëm me shkrim nga Zyra e Regjistrimit dhe vetëm pasi është kërkuar paraprakisht me shkrim, në rastet kur kërkuesi është i ndryshëm nga prokurori/oficeri që heton çështjen për të cilën kërkohet informacion.

Sekretare e Zyrës së Regjistrimit Fjoralba Salla për qëllime raportimi dhe statistikash mban, përditëson periodikisht dhe administron një regjistër të posaçëm elektronik të materialeve që lidhen me krimet zgjedhore.

Neni 9

Veprimtaria e nëpunësve civil

¹ Referuar shkresës nr.2077/1.prot dt.24.03.2021 të ILDKPKI.

Nëpunësit civil të prokurorisë, i japin përparësi kryerjes së detyrave të tyre që lidhen me veprimtarinë e prokurorit dhe/ose oficerit të ngarkuar për çështje zgjedhore, duke racionalizuar këtë veprimtari urgjente me veprimtarinë normale të tyre si dhe me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga akte të tjera të brendshme që janë në fuqi.

Kancelarja e prokurorisë ngarkohet të menaxhojë veprimtarinë administrative në këtë drejtim.

Punonjësve të policisë së shtetit të caktuar përkohësisht në detyrë sipas Urdhërit nr.2100, dt.19.02.2025 të Drejtorit të DVP Elbasan, për ushtrimin e funksioneve të tyre në çështjet zgjedhore, i vendoset në dispozicion Zyra Z.2 në katin 2, si dhe baza e nevojshme materiale të cilën e marrin në përdorim nën përgjegjësinë e tyre dhe e dorëzojnë më datë 31.05.2025.

Neni 10

Dispozita të fundit

Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe oficerët e kësaj prokurorie, kancelarja dhe punonjësit administrativ. Një kopje e këtij urdhëri i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti TI-së me kryerjen e njoftimit.

Kopje e këtij udhëzimi të dërgohet për njohje dhe zbatim pranë shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, të Komisariateve të Policisë Elbasan, Librazhd, Cërrik, Peqin dhe Gramsh, AMP Elbasan, Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë, si dhe Seksionin e Policisë Ushtarake Elbasan.


Çdo akt i brendshëm që bie në kundërshtim me këtë udhëzim, shfuqizohet.

Një kopje i përcillet Prokurorisë së Përgjithshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Prokurorisë së Përgjithshme.

DREJTUESI I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp is blue and contains the text "REPUBLIKË E SHQIPËS" at the top, "PROKURORIA E PËRGJITHSHME" around the middle, and "ELBASAN" at the bottom. In the center of the stamp is a smaller emblem.